

1 E hënë, 14 korrik 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Vendimi i Apelit]

4 [Apeluesi paraqitet përmes videolidhjes]

5 --- Seanca fillon në orën 11.30

6 GJYKATËSJA PICARD: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]

7 Mirëmëngjesi, mirë se erdhët të gjithë.

8 Ju lutem, Sekretari i seancës, paraqisni lëndën.

9 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Kjo është
10 lënda KSC-CA-2024-03, Prokurori i Specializuar kundër Pjetër
11 Shalës. Ju faleminderit.

12 GJYKATËSJA PICARD: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]

13 Faleminderit, Sekretar.

14 Vërej që z. Shala nuk është fizikisht në sallën e gjyqit,
15 por ai po na ndjek përmes videolidhjes sot.

16 Z. Shala, a e ndiqni -- po e ndiqni procesin në një gjuhë
17 që e kuptoni?

18 Z. SHALA: [Përmes videolidhjes] Mirëmëngjes. Po, e
19 ndëgjoj mirë dhe e kuptoj mirë.

20 GJYKATËSJA PICARD: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]

21 Faleminderit, z. Shala.

22 Ju lutem palëve dhe Mbrojtësit të Viktimave të
23 prezantohen, të fillojmë me avokatin e z. Shala, ju lutem.

24 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit që më dhatë fjalën.

25 Unë jam z. Gilissen. Me mua këtu është z. Shala, siç tha vetë

1 Gjykatësja, kam dhe bashkëmbrojtësin, z. Aouini, znj.
2 Cariolou; znjsh. Dzeneta Petravica, që është ndihmësjuriste;
3 Judit Kolbe, ndihmësjuriste, po ashtu; Seloua Ameziane, është
4 stazhiere; Imelda Mustafai, po ashtu stazhiere; dhe Paola
5 Ripoll, që është po ashtu stazhiere.

6 GJYKATËSJA PICARD: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]
7 Faleminderit, z. Gilissen.

8 Nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, ju lutem të
9 prezantohen.

10 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
11 Gjykatës. Nga ZPS-ja të pranishëm këtu është Kimberly West,
12 Peadar Thompson, Line Pedersen, Maria Wong, Sarah Clanton dhe
13 Filippo de Minicis.

14 GJYKATËSJA PICARD: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]
15 Faleminderit.

16 Ju lutem të prezantohet Mbrojtësi i Viktimave.

17 Z. LAWS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Unë jam Simon Laws, jam
18 Mbrojtësi i Viktimave në këtë lëndë gjyqësore, bashkë me
19 bashkëmbrojtësen time, Maria Radziejowska.

20 GJYKATËSJA PICARD: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]
21 Faleminderit.

22 Ju lutem Zyrës Administrative tani të prezantohet.

23 ADMINISTRATORJA: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Unë jam Fidelma
24 Donlon, jam Administratore, dhe bashkë me mua është dhe
25 Zëvendësadministratori, Jonas Nilsson.

1 GJYKATËSJA PICARD: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]

2 Faleminderit.

3 Për procesverbal, unë jam Michele Picard, që jam
4 Kryegjykatëse në këtë lëndë gjyqësore, dhe kolegët e mi
5 gjykatës janë Kai Ambos dhe Nina Jorgensen.

6 Tani do t'i jap fjalën kolegut tim, Gjykatësit Kai Ambos,
7 i cili do të lexojë përmbledhjen e aktgjykimit me Gjykatësen
8 Jorgensen. Në fund të leximit të përmbledhjes dhe vendimit unë
9 do të mbyll seancën.

10 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të gjithëve. Kjo
11 është një përmbledhje pak e hollësishme, kështu që ju lutem të
12 bëni pak durim sot.

13 Paneli i Gjykatës së Gjykatës së Apelit është mbledhur
14 sot për të shqiptuar aktgjykimin e apelit në çështjen
15 gjyqësore Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës. Ky
16 aktgjykim shqiptohet publikisht, në emër të popullit të
17 Kosovës, dhe në prani të të akuzuarit nëpërmjet
18 videokonferencës. Kjo përmbledhje përmban pikat themelore të
19 apeluara dhe konstatimet kryesore të Apelit të Panelit, dhe
20 nuk është aktgjykimi zyrtar dhe autoritativ i apelit.
21 Aktgjykimi me shkrim është i vetmi dokument autoritativ i
22 konstatimeve të Panelit të apelit. Aktgjykimi i apelit, në
23 version konfidencial dhe publik të redaktuar, do të vihet në
24 dispozicion në formë elektronike pas kësaj seance. Një kopje e
25 legalizuar e aktgjykimit të apelit në anglishte, do t'i jepet

1 z. Shala sot, dhe versioni në gjuhën shqipe do t'i jepet kur
2 të jetë gati.

3 Dhomat e Specializuara u krijuan në lidhje me akuza të
4 rënda për trajtim çnjerëzor, vrasje të personave dhe krime të
5 tjera të rënda të kryera gjatë dhe pas konfliktit të armatosur
6 në Kosovë midis 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2001.

7 Ky aktgjykim i apelit shënon një moment të rëndësishëm
8 për Dhomat e Specializuara pasi është aktgjykimi i dytë i
9 apelit në një çështje për krime lufte në këtë Gjykatë.
10 Aktgjykimi është një hap i rëndësishëm drejt vendosjes së
11 drejtësisë për viktimat dhe llogaridhënies.

12 Ky aktgjykim trajton apelin kundër konstatimeve të Trupit
13 Gjykues në lidhje me përgjegjësinë e z. Shala, anëtar i
14 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ose përndryshe UÇK, për krime
15 të kryera në fabrikën e metalit në Kukës, në Republikën e
16 Shqipërisë, e njohur si fabrika e metalit në Kukës, ose shkurt
17 FMK, afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999.

18 Më 16 korrik 2024, Trupi Gjykues shqiptoi aktgjykimin, në
19 të cilin është shpallur z. Shala fajtor për tre akuza për
20 krime lufte. Ai u shpall fajtor për krimet e luftës së
21 ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme,
22 përkatësisht sipas Pikave 1, 3 dhe 4 të aktakuzës, dhe i
23 pafajshëm për krimin e luftës së trajtimit mizor sipas Pikës 2
24 të aktakuzës. Trupi Gjykues e dënoi z. Shala me dënim të
25 njësuar prej 18 vjetësh burgim në të cilën llogaritet koha e

1 kaluar në paraburgim.

2 Trupi Gjykses konstatoi se afërsisht midis 17 majit 1999
3 dhe 5 qershorit 1999 në FMK, së paku 18 personave iu hoq liria
4 nga z. Shala dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së. Trupi Gjykses
5 konstatoi se kjo ndodhi në kontekstin e konfliktit të
6 armatosur jo-ndërkombëtar ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe.
7 Trupi Gjykses gjithashtu konstatoi se, gjatë të njëjtës
8 periudhës kohore, z. Shala dhe anëtarë të UÇK-së i mbajtën të
9 ndaluarit në FMK në kushte çnjerëzore dhe poshtëruese dhe i
10 keqtrajtuan rregullisht, si fizikisht dhe psikologjikisht, me
11 qëllim marrjen e informacionit ose të deklaratave pranuese
12 prej tyre, dhe/ose për t'i ndëshkuar, frikësuar, detyruar
13 dhe/ose diskriminuar për arsye politike. Së fundi, Trupi
14 Gjykses konstatoi se personi i përmendur si viktima e vrasjes
15 së paligjshme vdiq gjatë kohës që ishte ende i ndaluar në FMK,
16 më 5 qershor 1999, ose rreth kësaj date, nga pasojat e plagëve
17 me armë zjarri të shkaktuara nga një anëtar i UÇK-së në prani
18 të z. Shala, dhe refuzimit të trajtimit mjekësor të duhur.
19 Megjithëse u konstatua se z. Shala nuk kishte personi që
20 qëllloi me armë zjarri viktimën e vrasjes së paligjshme, Trupi
21 Gjykses konstatoi se ai ishte i pranishëm në dhomë kur u
22 qëllua viktima e vrasjes së paligjshme dhe mori pjesë
23 gjithashtu në keqtrajtimin e tij para se të qëllohej dhe pasi
24 u qëllua me armë zjarri.

25 Z. Shala dorëzoi një apel kundër verdikteve të fajësisë

1 sipas Pikave 1, 3 dhe 4 të aktakuzës dhe një numri
2 konstatimesh të Trupit Gjykses të bëra në lidhje me to.

3 Z. Shala kërkoi që Paneli i Apelit të anulojë verdiktet e
4 fajësisë të shpallura nga Trupi Gjykses sipas Pikave 1, 3 dhe
5 4 të aktakuzës ose, si alternativë, t'ia kthejë çështjen
6 Trupit Gjykses për rigjykim ose, si alternativë, të ulë
7 dënimin e dhënë.

8 Z. Shala apeloj gjithashtu Urdhrin për Zhdëmtim të
9 lëshuar nga Trupi Gjykses më 29 nëntor 2024, në të cilin, tetë
10 viktimave pjesëmarrëse në proces iu akorduan dëmshpërblime.
11 Aktgjykimi mbi apelin e z. Shala kundër Urdhrit për Zhdëmtim
12 do të lëshohet më vete më vonë.

13 Paneli i Apelit dëgjoi parashtrimet gojore të palëve dhe
14 Mbrojtësit të Viktimave më 15 dhe 16 maj 2025.

15 Apeli i z. Shala kundër aktgjykimit përmban 14 pika në të
16 cilat ai parashtron argumente në lidhje me pretendime për
17 gabime ligjore, faktike dhe në përcaktimin e dënimit nga Trupi
18 Gjykses.

19 Paneli i Apelit, së pari, i referohet standardit të
20 shqyrtimit të apeleve kundër aktgjykimeve të Trupit Gjykses
21 sipas nenit 46 të Ligjit. Paneli i Apelit mund t'i lërë në
22 fuqi, prapësojë ose ndryshojë aktgjykimet e Trupit Gjykses,
23 dhe të marrë masa të përshtatshme për arsyet vijuese: një,
24 "gabim ligjor që zhvlerëson aktgjykimin"; dy, "gabim faktik që
25 ka shkaktuar gabim gjyqësor"; ose, tre, "gabim në përcaktimin

1 e dënimit".

2 Për arsye të shtjelluara gjerësisht në aktgjykimin e
3 apelit, Paneli rikujton edhe diskrecionin e gjerë të Trupit
4 Gjykues për vlerësimin e provave në përcaktimin e dënimit të
5 përshtatshëm. Në lidhje me këtë, Paneli thekson se nuk do t'i
6 përmbysë lehtësisht konstatimet faktike të Trupit Gjykues,
7 sepse Trupi Gjykues është në pozitën më të mirë për dëgjimin,
8 vlerësimin dhe peshimin e dëshmime të paraqitura gjatë
9 gjykimit. Gjithashtu, Paneli i Apelit nuk do të ndërhyjë në
10 dënimin e dhënë nga Trupi Gjykues, përveçse kur ka kryer gabim
11 të dallueshëm në ushtrimin e diskrecionit të vet ose nuk ka
12 zbatuar dispozitat ligjore përkatëse.

13 Trupi Gjykues thekson se për të mundësuar që kjo seancë
14 të jetë publike, dëshmitarët e mbrojtur dhe viktimat nuk do të
15 identifikohen dhe do të përmenden përgjithësisht vetëm kur
16 është e nevojshme. Më shumë hollësi jepen në aktgjykimin e
17 apelit.

18 Paneli tani do të përmbledhë konstatimet kryesore të
19 aktgjykimit të vet duke filluar me Pikën 9 të apelit të z.
20 Shala për pretendime të shkeljes së të drejtave të Mbrojtjes.

21 Së pari, në Nënpikën 9(A) të apelit, z. Shala pretendon
22 shkelje të përsëritura të ZPS-së në lidhje me nxjerrjen e
23 materialeve. Z. Shala përmendi konkretisht shembullin e
24 Dëshmitarit 2540, duke pretenduar se nxjerrja me vonesë e
25 materialeve në lidhje me këtë dëshmitar e dëmtoi atë sepse

ndryshe do ta kishte thirrur dëshmitarin për të dëshmuar. Paneli i Apelit konstaton se pretendimet e përgjithshme të z. Shala për shkelje në lidhje me nxjerrjen e materialeve duhet të rrëzohen sepse mungon baza e nevojshme. Në lidhje me aspektin e nxjerrjes me vonesë të provave lidhur me Dëshmitarin 2540, sikurse shtjellohet më gjerësisht në aktgjykimin e apelit, konkretisht në lidhje me Pikën 10 të apelit, Paneli i Apelit konstaton se z. Shala nuk ka arritur të provojë pretendimin për dëm dhe se Trupi Gjykses nuk gaboi që rrëzoi argumentet e z. Shala gjatë gjykimit.

Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon Nënrikën 9(A).

Së dyti, Paneli trajton pretendimin e z. Shala në Nënrikën 9(B) se Trupi Gjykses vuri kufizime të tepruara për dëshmitarët që mund të thirreshin nga Mbrojtja. Paneli i Apelit konstaton se z. Shala ka hequr dorë nga e drejta e tij për të kundërshtuar në fazën e apelit vendimin e Trupit Gjykses që urdhëroi heqjen e pesë dëshmitarëve nga lista e dëshmitarëve të Mbrojtjes. Ai as nuk e ngriti këtë kundërshtim gjatë gjykimit as nuk ka provuar rrethanat e posaçme që përlligjnin shqyrtimin e argumenteve të tij për të parën herë në fazën e apelit.

Rrjedhimisht, Paneli rrëzon Nënrikën 9(B) të apelit.

Së treti, në Nënrikën 9(C), z. Shala kundërshton faktin se gjykimi filloi përpara se Mbrojtja të ishte gati për të, dhe para se të përfundonte hetimet. Paneli i Apelit konstaton

1 se z. Shala nuk ka arritur të provojë gabim të Trupit Gjykses.
2 Paneli konstaton më tej se Trupi Gjykses në fakt mori masat
3 për t'i mundësuar Mbrojtjes kryerjen e hetimeve dhe
4 përgatitjet e saj për gjykim.

5 Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon Nënrikën 9(C).

6 Së fundi, në Nënrikën 9(D) të apelit, z. Shala argumentoi
7 se Trupi Gjykses nuk pranoi ndikime në aftësinë e tij për t'u
8 mbrojtur gjatë kohës që ka kaluar midis ngjarjeve të
9 paraqitura nga aktakuzë dhe gjykimit.

10 Paneli i Apelit konstaton se z. Shala thjesht përsërit
11 argumentet e rrëzuara gjatë gjykimit pa provuar se si rrëzimi
12 i tyre prej Trupit Gjykses ishte i gabuar. Paneli konstaton më
13 tej se z. Shala nuk ka arritur të provojë se si aftësia e tij
14 për të përgatitur mbrojtjen e vet u cëna rëndë si rezultat i
15 kohës që ka kaluar.

16 Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon Nënrikën 9(D) të
17 apelit.

18 Bazuar në sa më lartë, Paneli i Apelit rrëzon Pikën 9 të
19 apelit.

20 Paneli do trajtojë tani pretendimet për gabime në lidhje
21 me deklaratat e mëparshme të z. Shala në Pikat 1, 2 dhe
22 Nënrikën 8(B) të apelit.

23 Z. Shala ngriti pretendime për një numër gabimesh të
24 Trupit Gjykses në lidhje me pranimin dhe vlerësimin e
25 deklaratave të mëparshme të tij në kuadrin e disa pikave të

1 apelit, konkretisht, Pikat 1, 2 dhe 8 -- 9 -- 8(B). Paneli i
2 ka shqyrtuar këto pika bashkërisht. Ndër deklaratat e
3 mëparshme të z. Shala të përmendura në aktgjykimin e apelit
4 përfshihen transkriptet e intervistave të dhëna nga z. Shala
5 Zyrës së Prokurorit të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-
6 Jugosllavinë, përndryshe TPNJ, në 2005-n dhe 2007-n, dhe
7 Policinë Gjyqësore Federale Belge më 2016-n dhe 2019-n.

8 Së pari, në Pikën 1 të apelit, z. Shala kundërshtoi
9 pranimin dhe mbështetjen e Trupit Gjykues në deklaratat e
10 mëparshme të tij me pretendimin se ato ishin marrë në shkelje
11 të së drejtave të tij për gjykim të drejtë.

12 Paneli rikujton se në një vendim të lëshuar gjatë fazës
13 së gjyimit, Dhoma e Gjykatës së Apelit trajtoi aspekte të
14 ngjashme dhe la në fuqi vendimin e Trupit Gjykues për të
15 pranuar si prova deklaratat dhënë TPNJ-së më 2005-n dhe 2007-
16 n.

17 Rrjedhimisht, sa i përket deklaratave dhënë TPNJ-së,
18 Paneli nuk arrin të kuptojë se si mbështetja në prova të
19 pranuara sipas rregullit gjatë gjyimit, në vetvete, mund të
20 përbëjë shkelje siç pretendon z. Shala.

21 Në lidhje me deklaratat dhënë autoriteteve belge, Dhoma e
22 Gjykatës së Apelit konstatoi në një vendim të mëparshëm se z.
23 Shala nuk u lejua të kontaktonte avokat gjatë intervistës me
24 autoritetet belge më 2016-n dhe se Trupi Gjykues gaboi që doli
25 me një konstatim të ndryshëm. Megjithatë, duke marrë parasysh

garancitë procedurale të tjera që iu ofruan z. Shala në kontekst të kësaj interviste, u konstatua se kuadri i shkeljes ishte i kufizuar dhe Dhoma e Gjykatës së Apelit la në fuqi vendimin e Trupit Gjykues që gjykoi se deklarata dhënë autoriteteve belge në 2016-n, dhe citoj "nuk ishte e papranueshme".

Në fund të fundit, Trupi Gjykues nuk u mbështet në deklaratën dhënë autoriteteve belge në 2016-n për konstatimet në aktgjykim. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon argumentet e z. Shala për të kundërtën.

Gjithashtu, për arsyet e shtjelluara në aktgjykimin e apelit, Paneli rrëzon argumentin e z. Shala se për shkak se deklaratat dhënë autoriteteve belge më 2016-n u morën në shkelje të drejtave të tij, "doktrina e frutit të pemës helmuese" ndalon përdorimin e deklaratës dhënë autoriteteve belge më 2019-n.

Sa i përket argumenteve të z. Shala në lidhje me deklaratën dhënë autoriteteve belge më 2019-n, Dhoma e Gjykatës së Apelit rrëzoi pretendime të ngjashme për shkelje gjatë fazës së gjykimit. Paneli rrëzon gjithashtu argumentin e z. Shala se Trupi Gjykues shkeli të drejtat e tij për gjykim të drejtë, që në aktgjykim u mbështet kryesisht në deklaratën dhënë autoriteteve belge më 2019-n. Në lidhje me këtë, Paneli konstaton se deklarata dhënë autoriteteve belge më 2019-n u trajtua me kujdesin e duhur dhe Trupi Gjykues u mbështet në të

1 vetëm kur konfirmohet në provat -- nga prova të tjera. Paneli
2 rrëzon gjithashtu argumentet e tjera të z. Shala në lidhje me
3 këtë deklaratë.

4 Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon Pikën 1 të Apelit.

5 Në Pikën 2 të Apelit, z. Shala, argumentoi se Trupi
6 Gjykues gaboi që refuzoi të merrte vendim në lidhje me
7 pranueshmërinë e shumë provave jогоjore gjatë procesit. Për
8 arsyet e shpjeguara në aktgjykimin e apelit, Paneli do të
9 trajtojë vetëm argumentet në lidhje me argument -- me
10 deklaratat dhënë autoriteteve belge më 2016-n dhe 2019-n.
11 Paneli është i mendimit se rregulla 138(1) e Rregullores,
12 lexuar së bashku me nenin 40(6)(h) të Ligjit, nuk e detyron
13 Trupin Gjykues për të vendosur në lidhje me pranueshmërinë e
14 provave brenda një afati të caktuar. Në lidhje me këtë, Paneli
15 thekson se në Vendimin Kornizë mbi provat jогоjore, i datës 16
16 mars 2023, Trupi Gjykues vendosi të vlerësonte pranueshmërinë
17 e provave që janë prova jогоjore në fund të gjykit gjatë
18 kuvendimit në lidhje me aktgjykimin. Megjithatë, Trupi Gjykues
19 parashikoi mundësinë e lëshimit të vendimeve mbi
20 pranueshmërinë e provave që paraqiten gjatë gjykit në
21 rrethana të jashtëzakonshme. Paneli gjykon se përdorimi i
22 këtij përjashtimi ishte i përligjur në lidhje me deklaratat
23 dhënë autoriteteve belge duke pasur parasysh llojin
24 inkriminues të provave që kundërshtohen dhe për arsye se palët
25 kishin kërkuar shprehimisht që Trupi Gjykues të lëshonte një

1 vendim lidhur mbi pranueshmërinë e atyre deklaratave.

2 Rrjedhimisht, Paneli i Apelit konstaton se z. Shala ka
3 provuar se Trupi Gjykses gaboi që nuk lëshoi një vendim mbi
4 pranueshmërinë e deklaratave dhënë autoriteteve belge pas
5 paraqitjes ose në kuadër të Vendimit Kornizë mbi provat
6 jogojore. Megjithatë, z. Shala nuk arriti të provonte dëmin që
7 iu shkaktua në lidhje me këtë.

8 Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon Pikën 2 të apelit.

9 Në lidhje me Nënpikën 8(B), Paneli rishikoi me kujdes
10 konstatimet e Trupit Gjykses të apeluar nga z. Shala, por
11 konstaton se ai nuk arriti të provonte se formulimi që përdori
12 Trupi Gjykses në vlerësimin për disa deklarata të mëparshme të
13 tij ia kaloi Mbrojtjes detyrimin e vërtetimit.

14 Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon Nënpikën 8(B) të
15 apelit. Paneli i Apelit do të trajtojë tani pretendimin e z.
16 Shala në Pikën 3 të apelit se Trupi Gjykses shkeli parimin e
17 ligjshmërisë.

18 Dhe tani ja kaloj fjalën Gjykatës Jorgensen.

19 GJYKATËSJA JORGENSEN: [Përkthim] Në Pikën 3 të apelit, z.
20 Shala parashtroi se me shpalljen e tij fajtor për ndërmarrje
21 kriminale të përbashkët, ose përndryshe NKP, për krimin e
22 luftës të ndalimit arbitrar në një konflikt të jo-armatosur
23 ndërkombëtar, Trupi Gjykses shkeli parimin e ligjshmërisë të
24 mishëruar në nenin 33 të Kushtetutës, nenin 6 dhe 7 të
25 Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenin 15 të

1 Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.

2 Së pari, z. Shala, argumentoi se zbatimi i drejtpërdrejt
3 i të drejtës zakonore ndërkombëtare nga Trupi Gjykses, dhe
4 rrjedhimisht verdikti fajësisë për krime sipas të drejtës
5 zakonore ndërkombëtare shkel parimin e ligjshmërisë, duke
6 pasur parasysh se as kushtetuta e Republikës Socialiste
7 Federative të Jugosllavisë, që ishte në fuqi në kohën
8 përkatëse, dhe as Kushtetuta e Kosovës nuk lejojnë zbatimin e
9 drejtpërdrejtë të normave të së drejtës ndërkombëtare përveç
10 nëse përmbushen "standardet e dualizimit". Paneli i Apelit
11 rrëzon argumentet e z. Shala duke patur parasysh se ato janë
12 trajtuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Dhoma e
13 Gjykatës së Panelit dhe Dhoma e Gjykatës Kushtetuese.

14 Së dyti, z. Shala parashtroi se NPK-ja si formë e
15 përgjegjësisë penale dhe krimi i luftës së ndalimit arbitrar
16 në një konflikt të armatosur jo-ndërkombëtar nuk ishin pjesë e
17 legjislacionit të Kosovës, as nuk ishin të përcaktuara sipas
18 të drejtës zakonore ndërkombëtare në 1999-n. Ai argumentoi
19 gjithashtu se ato as nuk ishin të parashikueshme as të
20 disponueshme për të akuzuarin, në kuptimin që ai nuk mund të
21 dinte se cilat forma të përgjegjësisë penale përbënin krime.
22 Në lidhje me këtë, z. Shala parashtroi se Trupi Gjykses duhej
23 të kishte marrë parasysh, ndër faktorë të tjerë, mospasjen e
24 tij të një pozite në UÇK dhe shkollimin e pamjaftueshëm,
25 paqartësitë në lidhje me elementet e krimit të ndalimit

1 arbitrar dhe mungesën e kapacitetit organizativ ose ndonjë
2 kapaciteti tjetër të UÇK-së më 1999-n.

3 Paneli vëren se z. Shala përsërit kryesisht argumentet
4 tashmë të paraqitura të rrëzuara nga Dhoma e Gjykatës së
5 Apelit në vendime të mëparshme në të cilat u mbështet Trupi
6 Gjykues. Ai konstaton se z. Shala nuk ka arritur të tregojë
7 arsye bindëse që do të çonin Panelin në një konstatim të
8 ndryshëm në lidhje me juridiksionin e Dhomave të Specializuara
9 mbi NKP-në ose ndalimin arbitrar në një konflikt të armatosur
10 jo-ndërkombëtar.

11 Në lidhje me argumentet e tjera të z. Shala për
12 parashikueshmërinë, Paneli i gjykon jobindëse duke pasur
13 parasysh vlerësimin tërësor të faktorëve relevantë, provave të
14 administruara dhe konstatimeve të tjera të Trupit Gjykues.

15 Rrjedhimisht, Paneli i Apelit konstaton se z. Shala nuk
16 ka arritur të provojë gabim, dhe rrjedhimisht rrëzon Pikën 3
17 të apelit.

18 Paneli i Apelit tani do të trajtojë kundërshtimet e z.
19 Shala në lidhje me aktakuzën në Pikat 4, dhe 5 të apelit.
20 Fillojmë me Pikën 5.

21 Në Pikën 5 të apelit, z. Shala pretendoi se Trupi Gjykues
22 gaboi që e shpalli fajtor për akuzat e ndalimit arbitrar dhe
23 torturës në lidhje me së paku 18 viktima, ndërkohë që në
24 aktakuzë ai akuzohej vetëm në lidhje me nëntë viktima.

25 Paneli i Apelit fillimisht vëren se Trupi Gjykues nuk

1 analizoi nëse aktakuza kishte mangësi në këtë aspekt. Paneli
2 gjykon se Trupi Gjykses duhej të kishte dhënë arsyet e
3 vendimit për verdiktet e fajësisë kundër z. Shala në lidhje me
4 një numër më të madh personash sesa u paraqit fillimisht në
5 aktakuzë.

6 Paneli i Apelit konstaton se mosdhënia e këtyre arsyeve
7 prej Trupit Gjykses përbën gabim ligjor.

8 Në lidhje me pretendimin se aktakuza kishte mangësi,
9 Paneli mban parasysh vendimin e mëparshëm të Dhomës së
10 Gjykatës së Apelit në këtë çështje se në aktakuzë janë
11 paraqitur si duhet identitetet dhe numri i viktimave të
12 pretenduara. Megjithatë, ky konstatim u bazua në premisën se
13 provat e ZPS-së kufizoheshin, dhe këtu citoj, "së paku nëntë
14 persona".

15 Duke pasur parasysh kuadrin e kufizuar të kësaj
16 çështjeje, Paneli gjykon se nevojitet një nivel më i lartë
17 konkretësie sesa në çështjet e një shkalle më masive dhe se
18 kriteret e argumentimit në lidhje me viktimat e pretenduara
19 janë përkatësisht më të larta. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit
20 konstaton se shprehja "së paku nëntë persona" në aktakuzë nuk
21 ishte mjaftueshëm konkrete dhe se aktakuza pati mangësi në
22 lidhje me nëntë personat e tjerë që pretendohet se u mbajtën
23 të ndaluar në FMK.

24 Për arsye të përshkruara më me hollësi në aktgjykimin e
25 apelit, Paneli konstaton se kjo mangësi në aktakuzë ishte

1 sidoqoftë e korigjueshme pasi nuk përbënte akuzë të re - që
2 paraqiste një bazë të re për verdiktin e fajësisë, të ndryshme
3 nga akuzat tashmë të pranishme në aktakuzë dhe nuk çoi në një
4 transformim rrënjësor të akuzave të ZPS-së kundër z. Shala.

5 Paneli konstaton se mangësia në aktakuzë më pas u
6 korigjua nëpërmjet informacionit të përfshirë në dosjen
7 paraprahe të ZPS-së ku përmenden shprehimisht ndalimi arbitrar
8 dhe keqtrajtimi i së paku 18 personave. Rrjedhimisht, Paneli
9 konstaton se z. Shala u njoftua si duhet se akuzohej në lidhje
10 me së paku 18 viktime dhe se atij iu dha mundësia të
11 përgatiste mbrojtje të njëmend kundër këtyre akuzave. Këtë
12 përfundim e përforcon edhe analizimi i sjelljes së Mbrojtjes
13 së z. Shala që pasqyron dijeninë e tij se ai akuzohej në
14 lidhje me pretendime që përfshinin së paku 18 viktime.

15 Për rrjedhojë, Paneli i Apelit konstaton se gabimet e
16 Trupit Gjykses nuk zhvlerësojnë vendimin e tij për shpalljen
17 fajtor të z. Shala mbi këtë bazë.

18 Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon Pikën 5 të apelit.

19 Paneli i Apelit tani do të shqyrtojë Nën-pikën 4(A) të
20 apelit, në të cilën z. Shala argumentoi se Trupi Gjykses e
21 shpalli fajtor në bazë të një aktakuze me mangësi në lidhje me
22 (i) identitetet e tre anëtarëve të pretenduar të NKP-së; dhe
23 (ii) identitetet e viktimave të pretenduara.

24 Së pari, në lidhje me anëtarët të NKP-së, Paneli vë në
25 dukje se në aktgjykim Trupi Gjykses identifikoi z. Osman

1 Kryeziu dhe z. Fatmir Limaj si anëtarë të NKP-së, ndërkohë që
2 në aktakuzë ata nuk përmendeshin shprehimisht si të tillë. Sa
3 i takon z. Sokol Dobruna, Paneli vëren se në kundërshtim me
4 pretendimin e z. Shala, Trupi Gjykues nuk e përmendi atë me
5 emër si anëtar të NPK-së.

6 Duke rikujtuar se në aktakuzë nuk ka nevojë të paraqiten
7 prova që vërtetojnë materialet -- faktet materiale të
8 pretenduara që mbështesin akuzat, Paneli gjykon se
9 identifikimi i z. Kryeziu dhe i z. Fatmir Limaj si anëtarë të
10 NPK-së nuk përbën fakt material por ka të bëjë me provat.
11 Rrjedhimisht, aktakuza nuk ka mangësi, pasi këta persona
12 përfshihen në kategorinë, e këtui citoj, "disa ushtarë, policë
13 dhe roje të tjera të UÇK-së", të përmendur në aktakuzë. Bazuar
14 në sa më lart, Paneli është bindur se Trupi Gjykues nuk gaboi
15 kur në bazë të provave të paraqitura në gjykim në fund
16 identifikoi se z. Kryeziu dhe z. Fatmir Limaj ishin anëtarë të
17 tjerë të identifikuar të NPK-së.

18 Së dyti, në lidhje me viktimat, Paneli konstaton se
19 aktakuza nuk ishte mjaftueshëm konkrete në lidhje identitetet
20 e nëntë viktimave të tjera. Paneli i Apelit konstaton
21 gjithashtu se Trupi Gjykues gaboi që nuk trajtoi aspektin nëse
22 aktakuza kishte mangësi dhe që rrjedhimisht nuk konstatoi se
23 aktakuza ishte e mangët në këtë aspekt. Megjithatë, Paneli
24 gjykon se mangësia në aktakuzë u korrigjua nga informacioni që
25 përmbante dosja paraprake e ZPS-së, dhe se z. Shala u njoftua

1 si duhet lidhur me identitetet e viktimave të tjera. Si
2 rezultat, Paneli i Apelit konstaton se gabimet e Trupit
3 Gjykues nuk zhvlerësojnë vendimin për shpalljen fajtor të z.
4 Shala mbi këtë bazë.

5 Rrjedhimisht, Paneli rrëzon Nënpikën 4(A) të apelit.

6 Në lidhje me Nënpikën 4(B) të apelit, z. Shala argumentoi
7 se aktakuza përmbante akuza të shumëfishta të palejueshme për
8 torturë dhe trajtim mizorin. Për arsye të shtjelluara në
9 aktgjykimin e apelit, Paneli konstaton se z. Shala nuk arriti
10 të provonte se Trupi Gjykues gaboi në qasjen lidhur me akuzat
11 e shumëfishta. Paneli konstaton gjithashtu se z. Shala nuk
12 arriti të provonte se ai u dëmtua si rezultat i akuzave të
13 shumëfishta për torturë dhe trajtim mizor në aktakuzë.

14 Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon Nënpikën 4(B) të
15 apelit.

16 Paneli i Apelit do të trajtojë kundërshtimet e z. Shala
17 ndaj qasjes së Trupit Gjykues në lidhje me vlerësimin e
18 dëshmitarëve. Këto lidhen me Pikat 6 dhe 10 të apelit.

19 Si çështje paraprake, Paneli i Apelit rikujton se Trupi
20 Gjykues ka diskrecion të gjerë për vlerësimin e besueshmërisë
21 së dëshmitarëve dhe mbështetshmërinë në dëshmitë e tyre dhe se
22 Paneli nuk i rrëzon lehtë konstatimet faktike të Trupit
23 Gjykues në lidhje me këtë aspekt. Paneli rikujton gjithashtu
24 se e drejta e të akuzuarit për mendim të arsyetuar nuk kërkon
25 analizë të hollësishme të besueshmërisë së dëshmitarëve, në

1 goftë se Trupi Gjykses jep arsye për pranimin e dëshmisë së
2 dëshmitarit, pavarësisht nga ndonjë mospërputhje të pretenduar
3 apo juridikisht thelbësore.

4 Nga Nënpiakat 6(A), 6(B) dhe (6C) të apelit, z. Shala,
5 kundërshtoi vlerësimin e Trupit Gjykses lidhur me
6 besueshmërinë e tre dëshmitarëve kyç të ZPS-së. Për arsyet e
7 shtjelluara në aktgjykimin e apelit, Paneli i Apelit konstaton
8 se z. Shala nuk arriti të provonte se Trupi Gjykses kishte
9 keqpërdorur diskrecionin e vet në mënyrën se si vlerësoi
10 besueshmërinë e Dëshmitarëve 401, 4733 dhe 1448.

11 Në lidhje me kundërshtimet e z. Shala të paraqitura në
12 Nënpiakën 6(D) të apelit, Paneli konstaton se z. Shala nuk
13 arriti të provonte se Trupi Gjykses gaboi në konstatimin se
14 nuk kishte komprometim të provave ose marrëveshje ndërmjet
15 dëshmitarëve të ZPS-së si dhe mes anëtarëve të familjes së
16 Dëshmitarit 4733.

17 Së fundi, në lidhje në Nënpiakën 6(E) të apelit, sikurse
18 zhvillohet edhe më tej në aktgjykimin e apelit, Paneli
19 konstaton se z. Shala nuk arriti të provonte se Trupi Gjykses
20 keqpërdori diskrecionin e vet dhe zbatoi standarde të dyfishta
21 kur arriti në përfundime të ndryshme në lidhje me
22 mospërputhjet në dëshmitë e dëshmitarëve.

23 Në përfundim, Paneli i Apelit rrëzon Pikën 6 të apelit.

24 Paneli do të trajtojë tani vlerësimin e dëshmimeve të
25 dëshmitarëve të Mbrojtjes.

1 Në Pikën 10, z. Shala kundërshton vlerësimin e Trupit
2 Gjykues për dëshmitarët e Mbrojtjes, konkretisht se Trupi
3 Gjykues shqyrtoi faktorë jo-relevantë, si përkrahjen e
4 dëshmitarëve për UÇK-në, mendimet politike të tyre dhe
5 armiqësinë kundrejt Dhomave të Specializuara.

6 Paneli fillimisht konstaton se Trupi Gjykues artikuloi
7 qartë qasjen ndaj vlerësimit të provave në këtë çështje
8 gjyqësore, veçanërisht në lidhje me vlerësimin e besueshmërisë
9 së dëshmitarëve dhe mbështetshmërinë e dëshmive të tyre
10 përpara sesa të mbështetej në to. Siç shtjellohet më tej në
11 aktgjykimin e apelit, Paneli gjithashtu gjykon se Trupi
12 Gjykues vlerësoi me kujdes besueshmërinë e dëshmitarëve të
13 kundërshtuar të Mbrojtjes si dhe dha arsyetim të mjaftueshëm
14 në mbështetje të përfundimeve të veta për trajtimin e provave
15 të tyre me kujdes shumë të madh ose si prova aspak të
16 besueshme.

17 Paneli gjithashtu gjykon se qasja përputhëse e Trupit
18 Gjykues në vlerësimin e të gjithë dëshmitarëve nuk përmban
19 asnjë tregues për anshmëri konkrete kundër dëshmitarëve të
20 Mbrojtjes.

21 Paneli konstaton se z. Shala nuk arriti të provonte se
22 Trupi Gjykues gaboi apo keqpërdori diskrecionin e vet në
23 vlerësimin e dëshmitarëve të Mbrojtjes.

24 Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon pikën 10 të apelit.

25 Paneli i Apelit tani do të trajtojë kundërshtimet e z.

1 Shala ndaj mbështetjes së Trupit Gjykues në prova të
2 paverifikuara.

3 Këto lidhen me Pikat 7, dhe pjesërisht, 12 të apelit.

4 Në Pikën 7, z. Shala argumentoi së në kundërshtim me
5 rregullën 140(4)(a) të Rregullores, Trupi Gjykues u bazua
6 vetëm, ose në masë vendimtare, në prova të paverifikuara për
7 të bërë disa konstatime konkrete. Këto konstatime u cilësuan
8 si "Konstatime Themelore të Apeluara" prej Panelit të Apelit
9 në aktgjykimin e apelit, dhe kanë të bëjnë me synimin kriminal
10 ose elementin mendor për ndalimin arbitrar dhe synimin
11 kriminal e veprimin e fajshëm ose elementin material për
12 torturën, si dhe në lidhje me anëtarësimin e z. Shala në NKP,
13 kontributin e qenësishëm të tij në të dhe qëllimin e
14 përbashkët të NKP-së. Gjithashtu, z. Shala apeloj verdiktet e
15 fajësisë së tij për torturë ndaj katër personave dhe ndalim
16 arbitrar të gjashtë personave. Kundërshtimin e z. Shala kundër
17 verdiktit të fajësisë së ndaj tij për torturë të ushtruar ndaj
18 një personi të pestë, që fillimisht u paraqit në Nën-pikën 8(A)
19 të apelit të z. Shala, u trajtua në Pikën 7 të apelit nga
20 Paneli.

21 Fillimisht për konstatimet themelore të apeluara të
22 Trupit Gjykues në lidhje me elementët e veprave penale të
23 torturës dhe ndalimit arbitrar si dhe në lidhje me NPK-në,
24 Paneli i Apelit vëren se Trupi Gjykues u bazua, në masë të
25 ndryshme, në prova të paverifikuara për formulimin e

konstatimeve faktike që ishin baza e Konstatimeve Themelore të Apeluara. Megjithatë, në lidhje me këtë, Trupi Gjykses u mbështet gjithashtu edhe në dëshmitë gojore të dëshmitarëve që u paraqiten në gjykim. Në veçanti, Paneli vëren se secili prej Konstatimeve Themelore të Apeluara u mbështet nga konstatimet faktike të Trupit Gjykses të cilat nga ana e tyre bazoheshin gjerësisht në dëshmitë gojore në sallën e gjyqit. Këto konstatime kishin të bënin me pjesëmarrjen personale të dy -- në dy raste konkrete të z. Shala në marrjen në pyetje dhe keqtrajtimin e të ndaluarve, konkretisht, në ato të cilave në aktgjykimin e apelit Paneli i Apelit iu referohet si Incidenti i 20 majit 1999 dhe Incidenti i Qëllimit me Armë Zjarri në këmbë, më 4 qershor 1999 ose rreth kësaj date.

Gjithashtu, Konstatimet Themelore të Apeluara në lidhje me veprimin e fajshëm dhe synimin kriminal për torturë në lidhje me anëtarësinë e z. Shala në NPK dhe në lidhje me qëllimin e përbashkët të NPK-së u mbështetën te konstatimet faktike, që nga ana e tyre bazoheshin në veçanti në dëshmi të një numri të dëshmitarëve në gjykim. Këtu përfshihen, për shembull, konstatimet faktike në lidhje me praktikën e organizuar të arrestimit të personave të ndaluar në FMK, raste të tjera të keqtrajtimit të të ndaluarve në FMK, si dhe praninë dhe veprimtarinë e z. Shala në FMK.

Bazuar në sa më lart, Paneli arrin në përfundimin se z. Shala nuk arriti të provonte se Trupi Gjykses u bazua vetëm

1 ose në masë vendimtare në prova të paverifikuara për
2 Konstatime Themelore të Apeluara në lidhje me elementet e
3 ndalimit arbitrar dhe të torturës si dhe me të NKP-së në
4 kundërshtim me rregullën 140(4)(a) të Rregullores.

5 Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon kundërshtimin e z.
6 Shala sipas Pikës 7 dhe Pikës 12 pjesërisht, që kanë të bëjnë
7 me Konstatimet Themelore të Apeluara.

8 Ende në lidhje me Pikën 7, në vijim, Paneli i Apelit do
9 të trajtojë apelin e z. Shala kundër verdiktit të fajësisë së
10 tij për torturë në lidhje me pesë persona konkretë.

11 Gjatë vlerësimit të themelësisë së argumentit të z.
12 Shala, dhe në përputhje me të drejtën penale ndërkombëtare dhe
13 parimet përkatëse të të drejtave të njeriut, Paneli i Apelit
14 fillimisht analizoi provat e përdorura të keqtrajtimit konkret
15 të këtyre pesë personave. Paneli, gjithashtu, analizoi provat
16 në të cilat u mbështet Trupi Gjykues për të konfirmuar
17 keqtrajtimin konkret të tyre. Në lidhje me këtë, Paneli mbajti
18 parasysh se vendimi nëse mbështetja në prova të paverifikuara
19 është "vendimtar" varet nga vlera provuese e provave
20 mbështetëse.

21 Në këtë aspekt, Paneli mbajti parasysh mbështetjen e
22 Trupit Gjykues në prova që konfirmonin praktikën e
23 keqtrajtimit kolektiv të të ndaluarve në FMK. Megjithatë,
24 Paneli i Apelit mbajti parasysh edhe konstatimin e Trupit
25 Gjykues se keqtrajtimi kolektiv i të ndaluarve në FMK

1 përfundoi faktikisht më 5 qershor 1999 ose rreth kësaj date.

2 Kjo përkoi me mbërritjen e rojeve të reja dhe me përmirësimin
3 material, si rezultat i kësaj, i kushteve të ndalimit në FMK,
4 përfshirë këtu dhe ndërprerjen e keqtrajtimit fizik të të
5 ndaluarve.

6 Në lidhje me këtë pikë, Paneli i Apelit rikujton se palët
7 nuk kanë qenë në gjendje të citonin ndonjë provë nga provat e
8 administruara në gjykim që sugjeronte se Trupi Gjykses kishte
9 gabuar në konstatimin e vet ose që do të mbështeste
10 konstatimin se keqtrajtimi kolektiv dhe sistematik i të
11 ndaluarve në FMK vazhdoi dhe pas kësaj date.

12 Gjatë vlerësimit të pamjaftueshmërisë së kësaj praktike
13 konfirmuese të keqtrajtimit kolektiv të të ndaluarve, Paneli i
14 Apelit së pari shqyrtoi nëse Trupi Gjykses kishte përcaktuar
15 se personi ishte ndaluar para këtij ndryshimi në kushtet e
16 ndalimit në FMK më 5 qershor 1999, ose rreth kësaj date, ose
17 me fjalë të tjera ndërkohë që vazhdonte keqtrajtimi kolektiv i
18 të ndaluarve.

19 Së dyti, Paneli shqyrtoi gjithashtu nëse z. Shala i ishte
20 dhënë mundësia të verifikonte provat në të cilat ishte bazuar
21 Trupi Gjykses për të bërë një përcaktim të tillë kritik.

22 Pasi kreu një vlerësim tërësor të provave në përputhje me
23 këtë qasje, Paneli i Apelit, konstaton se në gjykim nuk u
24 paraqitën dëshmi gojore të keqtrajtimit konkret të këtyre pesë
25 personave. Paneli konstaton gjithashtu se nuk u paraqitën

1 dëshmi gojore se këta persona ishin mbajtur të ndaluar në FMK
2 para 5 qershorit 1999. Ndonëse arsyet për këto konstatime
3 jepen në hollësi në aktgjykimin apelit, Paneli thekson se kjo
4 mangësi ishte kritike jo vetëm për konfirmimin, por edhe për
5 konstatimet e Trupit Gjykses se këta persona u vënë vunë në
6 kushte çnjerëzore ndalimi në FMK. Në fakt, në lidhje me tre
7 persona, Paneli vëren se nuk u paraqit asnjë dëshmi gojore për
8 vetë ndalimin e tyre në FMK pikësëpari. Rrjedhimisht, Paneli
9 konstaton se Trupi Gjykses u bazua në një masë vendimtare në
10 prova të paverifikuara kur e shpalli fajtor z. Shala për
11 torturë ndaj këtyre pesë personave.

12 Së fundi, Paneli trajton kundërshtimin e z. Shala ndaj
13 verdiktit të fajësisë për ndalimin arbitrar në lidhje me
14 gjashtë persona konkretë.

15 Paneli, së pari, konstaton se për shpalljen fajtor të z.
16 Shala për ndalimin arbitrar të katër prej gjashtë personave në
17 fjalë, Trupi Gjykses u mbështet, në masë të ndryshme, në
18 dëshmi gojore për rrethanat e ndalimit të tyre në FMK. Trupi
19 Gjykses gjithashtu u mbështet në provat e "praktikës së
20 veprimit" ku personave të arrestuar dhe të ndaluar në FMK iu
21 mohuan garancitë procedurale bazë. Pasi analizoi provat për
22 këto praktika, Paneli i Apelit konstaton se ato bazoheshin në
23 një masë të madhe në dëshmi gojore. Rrjedhimisht, Paneli i
24 Apelit konstaton se z. Shala nuk provoi se verdiktet e
25 fajësisë së tij për ndalim arbitrar në lidhje me këta persona

1 u bazuan vetëm ose në një masë vendimtare në prova të
2 paverifikuara.

3 Paneli rrëzon kundërshtimet e tij sipas Pikës 7 të apelit
4 në lidhje me to.

5 Sidoqoftë, nga ana tjetër, për sa i takon dy personave të
6 tjerë që ishin objekt i kundërshtimit të z. Shala, nuk u
7 paraqitën dëshmi gojore as për vetë ndalimin e tyre në FMK, e
8 aq më pak për rrethanat e ndalimit të tyre atje. Paneli
9 rikujton se u kishte kërkuar palëve të bënin parashtime në
10 seancën e apelit lidhur me mundësinë e gjetjes së provave të
11 tilla në dokumentacionin e gjykit. Në lidhje me këtë, Paneli
12 vë në dukje se palët nuk qenë në gjendje të citonin prova që
13 sipas Panelit të Apelit mund të konsideroheshin bindshëm si të
14 tilla. Paneli, gjithashtu, mbajti parasysh se nuk u dhanë
15 dëshmi konfirmuese të ndalimit të këtyre dy personave në FMK
16 prej dëshmitarëve të ZPS-së të cilët dhanë dëshmi në sallën e
17 gjyqit. Duke pasur parasysh se të vetmet provat të
18 administruara në gjykim në lidhje me ndalimin e tyre në FMK
19 janë të paverifikuara, Paneli i Apelit gjykon se verdikti i
20 fajësisë së z. Shala për ndalimin arbitrar të këtyre dy
21 personave u bazua në masë vendimtare në prova të
22 paverifikuara.

23 Si përfundim në lidhje me Pikën 7, Paneli i Apelit
24 konstaton se verdiktet e fajësisë së z. Shala për torturë ndaj
25 pesë personave, ndalim arbitrar të dy personave u dha në

shkelje të rregullës 140(4)(a) i Rregullores dhe i prapëson këto verdikte. Rrjedhimisht, Paneli miraton pjesërisht Pikën 7 të apelit dhe rrëzohen pjesën tjetër të kundërshtimeve të z. Shala të paraqitura nën këtë pikë.

Ndikimi i përfundimeve të arritura prej Panelit të Apelit në lidhje me dënimin e z. Shala do të trajtohet më poshtë.

Paneli i Apelit tani do të trajtojë kundërshtimet e z. Shala ndaj konstatimeve të Trupit Gjykues në lidhje me krimin e luftës të ndalimit arbitrar sipas Pikës 1. Këto lidhen me pikat 8(A), 11 dhe 12 të apelit të z. Shala.

Në Nënpiakat 8(A), 11 dhe 12 apelit, z. Shala kundërshtoi konstatimet e Trupit Gjykues në lidhje me veprimin e fajshëm dhe synimin kriminal për krimin e luftës të ndalimit arbitrar në një konflikt të armatosur jo-ndërkombëtar dhe në lidhje me përgjegjësinë e tij në bazë të kategorisë së parë të NPK-së ose NPK 1.

Paneli, së pari, do të trajtojë argumentet e z. Shala në lidhje me veprimin e fajshëm për krimin e luftës së ndalimit arbitrar. Fillimisht, Paneli i Apelit thekson se elementi i veprimit të fajshëm mund të përmbushet nëse provohet se të ndaluarit u mbajtën pa bazë ligjore ose se ndalimi nuk përmbushi garancitë procedurale bazë.

Paneli i Apelit, së pari, do të trajtojë pretendimin për gabime që buron nga konstatimi i Trupit Gjykues se ndalimi i të ndaluarve nuk përmbushi garancitë procedurale bazë. Paneli

1 i Apelit më pas do të trajtojë pretendimet për gabime që
2 burojnë nga konstatimi i Trupit Gjykses se të ndaluarit u
3 mbajtën pa bazë ligjore.

4 Sa i takon pretendimit për gabime ligjore, duke qenë se
5 z. Shala kundërshtoi elementet e veprimit të fajshëm për
6 krimin e luftës së ndalimit arbitrar, Paneli i Apelit e
7 konstaton këtë argument të pabazë.

8 Më tej, z. Shala kundërshtoi burimet ligjore ku u
9 mbështet Trupi Gjykses për interpretimin e dy prej tri
10 garancive bazë. Këto garanci janë detyrimi për të nxjerrë
11 personin e ndaluar para një gjykatësi ose një autoriteti
12 tjetër kompetent dhe detyrimi për t'i dhënë personit të
13 ndaluar mundësinë për të kundërshtuar ligjshmërinë e ndalimit.

14 Paneli i Apelit gjykon se z. Shala nuk ka arritur të
15 provojë gabim në burimet ligjore në të cilat u mbështet Trupi
16 Gjykses. Paneli i Apelit arrin në këtë përfundim duke mbajtur
17 parasysh se: (i) parimi i ligjshmërisë nuk e ndalon gjykatën
18 që të interpretojë dhe qartësojë elementët e një krimi; (ii)
19 objektivat e së drejtës për të drejtat e njeriut dhe të
20 drejtës humanitare ndërkombëtare përgjithësisht përputhen për
21 sa i përket ndalimit arbitrar; (iii) z. Shala nuk ka
22 artikuluar se pse parimet e evidentuara nuk vlejnë njësoj si
23 për konfliktet e armatosura ndërkombëtare ashtu edhe për ato
24 jo-ndërkombëtare; dhe (iv) Dhoma e Gjykatës së Apelit më herët
25 ka shqyrtuar dhe i ka rrëzuar këto argumente.

1 Gjithashtu, z. Shala pretendon se përfundimi i Trupit
2 Gjykues se rishikimi i ndalimit duhet të kryhet nga një
3 autoritet i pavarur përbën "një standard tejte të lartë".
4 Paneli i Apelit konstaton se në kontekstin e një konflikti të
5 armatosur, funksioni mbrojtës i moslejimit të ndalimit
6 arbitrar do të zhbëhej po qe se autoriteti që bën rishikimin e
7 ndalimit nuk do të ishte i pavarur nga ai që e urdhëron
8 ndalimin. Paneli konstaton se z. Shala nuk ka arritur të
9 provojë të kundërtën.

10 Z. Shala gjithashtu kundërshtoi konstatimin e Trupit
11 Gjykues se nuk ka rëndësi nëse "kryesi [i ndalimit arbitrar]
12 është personalisht përgjegjës për mosrespektimin e të drejtave
13 procedurale të të ndaluarit". Paneli i Apelit gjykon se z.
14 Shala nuk ka artikuluar se pse Trupi Gjykues gaboi që zbatoi
15 këtë parim në lidhje me një krim lufte në konflikt të
16 armatosur jo-ndërkombëtar.

17 Rrjedhimisht, dhe duke mbajtur parasysh arsyetimin e
18 mëtejshëm në aktgjykimin e apelit, Paneli i Apelit konstaton
19 se z. Shala nuk ka arritur të provojë se Trupi Gjykues bëri
20 gabim ligjor kur konstatoi se ndalimi i të ndaluarve nuk
21 përmbushi garancitë procedurale bazë.

22 Tani Paneli do të trajtojë pretendimet e z. Shala për
23 gabimet faktike në lidhje me konstatimet e Trupit Gjykues për
24 ndalim arbitrar.

25 Z. Shala, së pari, kundërshtoi konstatimet faktike të

1 Trupit Gjykues në lidhje me garancitë procedurale bazë dhe
2 veçanërisht përfundimin se të ndaluarit "nuk u nxorën pa
3 vonesë para një gjykatësi apo autoriteti tjetër kompetent". Z.
4 Shala argumentoi se Trupi Gjykues gaboi që konstatoi se asnjë
5 anëtar i UÇK-së në FMK nuk veproi si autoritet kompetent.

6 Së pari, Paneli vëren se megjithëse z. Shala pretendoi se
7 z. Kryeziu ushtronte funksionet e autoritetit kompetent, ai
8 nuk ka arritur të provojë se z. Kryeziu kishte nivelin e duhur
9 të pavarësisë apo se kishte kompetencë të mbikëqyrë në mënyrë
10 të pavarur ligjshmërinë e ndalimit apo të urdhëronte lirimin e
11 ndonjë të ndaluari. Paneli i Apelit gjithashtu gjykon se Trupi
12 Gjykues vlerësoi me kujdes dhe në hollësi dëshmitë e
13 Dëshmitarëve 402, 411 dhe 404, që konfirmuan se z. Kryeziu nuk
14 kishte kompetencë për mbikëqyrje të pavarur të ligjshmërisë së
15 ndalimit.

16 Së dyti, Paneli do të trajtojë kundërshtimet e z. Shala
17 ndaj konstatimit të Trupit Gjykues në lidhje me Dëshmitarin
18 4733.

19 Sipas Panelit ishte e arsyeshme që Trupi Gjykues të
20 konstatonte se z. Dobruna nuk kreu mbikëqyrje të pavarur të
21 ligjshmërisë së ndalimit të Dëshmitarit 4733, bazuar në faktin
22 se z. Dobruna e mori në pyetje Dëshmitarin 4733 bashkë me z.
23 Xhemshit Krasniqi, një anëtar i NPK-së që mori pjesë në
24 keqtrajtimin e këtij dëshmitari.

25 Paneli konstaton më tej, bazuar në arsyet që përmbahen në

1 aktgjykimin e apelit, se z. Shala nuk ka arritur të provojë se
2 Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se as z. Kryeziu dhe z.
3 Dobruna e asnjë ndonjë anëtar tjetër i UÇK-së nuk ushtruan
4 funksionin e një gjykatësi apo autoriteti të pavarur dhe se
5 Dëshmitarët 411, 404, 402, 4733 dhe 405 nuk u nxorën pa vonesë
6 para një gjykatësi ose një autoriteti tjetër kompetent.

7 Paneli do të trajtojë tani argumentet e z. Shala në
8 Nënrikën 8(A), konkretisht se Trupi Gjykses gaboi kur nxori
9 deduksione të paarsyeshme në kuadër të konstatimit se të
10 ndaluarit në FMK iu mohuan garancitë procedurale, veçanërisht
11 mundësia për të kundërshtuar ligjshmërinë e ndalimit të tyre.

12 Sa u përket kundërshtimeve të z. Shala në lidhje me
13 viktimën e vrasjes së paligjshme dhe Dëshmitarët 401, 411,
14 1448 dhe 405, për arsyet e shtjelluara në aktgjykimin e
15 apelit, Paneli është bindur se një gjykses i arsyeshëm faktesh
16 mund të kishte konstatuar në bazë të tërësisë së provave se i
17 vetmi përfundim i arsyeshëm ishte se atyre iu mohuan garancitë
18 procedurale dhe mundësia për të kundërshtuar ligjshmërinë e
19 ndalimit të tyre.

20 Gjithashtu, z. Shala kundërshtoi konstatimet e Trupit
21 Gjykses në lidhje me ndalimin e paligjshëm të shtatë të
22 ndaluarve të tjerë. Duke mbajtur parasysh provat bindëse të
23 administruara për kushtet e ndalimit dhe/ose praktikën e
24 vazhdueshme të mungesës së garancive procedurale në FMK,
25 Paneli është bindur në lidhje me gjashtë nga ndaluarit se një

1 gjykues i arsyeshëm faktesh mund të kishte konstatuar se i
2 vetmi deduksion i arsyeshëm ishte se atyre nuk iu dhanë
3 garancitë procedurale.

4 Në lidhje me të ndaluarin e shtatë, Paneli konstatoi se
5 kundërshtimi i z. Shala është i tejkaluar si rezultat i
6 konstatimeve të mëparshme të Panelit në kuadër të Pikës 7 të
7 apelit; konkretisht se verdikti i fajësisë së z. Shala për
8 ndalimin arbitrar të këtij të ndaluari u bazua në masë
9 vendimtare në prova të paverifikuara.

10 Po kështu, Paneli konstaton se kundërshtimet e z. Shala
11 lidhur me marrjen në pyetje dhe/ose keqtrajtimin e tre të
12 ndaluarve janë gjithashtu të tejkaluar bazuar në konstatime në
13 Pikën 7 të apelit në lidhje me të njëjtin të ndaluar.

14 Rrjedhimisht, Paneli konstaton se z. Shala nuk ka
15 arritur të provojë se Trupi Gjykses keqpërdori diskrecionin e
16 vet me deduksionet në kuadër të konstatimeve se të ndaluarve
17 në FMK iu mohuan garancitë procedurale.

18 Paneli i Apelit tani do të trajtojë kundërshtimet e z.
19 Shala në lidhje me konstatimet e Trupit Gjykses se të
20 ndaluarve iu hoq liria pa bazë ligjore. Më konkretisht, z.
21 Shala pretendoi se Trupi Gjykses gaboi në dy aspekte kur
22 arriti në përfundimin se "të ndaluarit nuk u mbajtën në FMK në
23 bazë të ndonjë akuze penale dhe as nuk kishte shqetësime për
24 sigurinë që e bënë ndalimin e tyre absolutisht të
25 domosdoshëm". Z. Shala argumentoi se Trupi Gjykses gaboi (i)

1 që nuk dha një mendim të arsyetuar; dhe (2) që konstatoi se ky
2 përfundim ishte i vetmi deduksion i arsyeshëm.

3 Paneli i Apelit gjykon se në arsyetimin e Trupit Gjykses
4 nuk bëhet e qartë nëse u shqyrtua se ndalimi i 18 të ndaluarve
5 ishte absolutisht i domosdoshëm. Në lidhje me këtë, Paneli i
6 Apelit vëren se nuk ka ndonjë paragraf më vete në aktgjykim
7 për këtë aspekt. Sidoqoftë, Trupi Gjykses: një, duket se mori
8 parasysh që nëntë nga 18 të ndaluarit u akuzuan shprehimisht
9 se ishin spiunë, tradhtarë ose bashkëpunëtorë të armikut; dhe,
10 dy, mori parasysh se të ndaluarit u mbajtën të ndaluar sipas
11 një "praktike veprimi".

12 Në lidhje me këtë praktikë veprimi, Paneli i Apelit është
13 i mendimit se përfundimet e Trupit Gjykses lënë të kuptohet se
14 të ndaluarit në këtë çështje u vunë në shënjestër për ndalim
15 nga UÇK-ja.

16 Së fundi, Paneli i Apelit thekson argumentet e ZPS-së se
17 "të gjithë të ndaluarit i mohuan" si të pavërteta akuzat
18 kundër tyre.

19 Paneli Apelit gjykon se në qoftë se Trupi Gjykses e mori
20 parasysh këtë kur arriti në konstatimin e kundërshtuar, kjo
21 nuk është e qartë nga arsyetimi i Trupit Gjykses.

22 Duke mbajtur parasysh sa më lart, si dhe arsyetimin e
23 mëtejshëm në aktgjykimin e apelit, Paneli i Apelit, konstaton
24 se z. Shala ka aprovuar se Trupi Gjykses nuk dha mendim të
25 arsyetuar kur konstatoi se asnjë akuzë penale ose shqetësim

1 për sigurinë nuk e bënin ndalimin e 18 të ndaluarve
2 absolutisht të domosdoshëm. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit
3 prapëson këtë konstatim dhe miraton pjesërisht Pikën 12 të
4 apelit të z. Shala. Mbi këtë bazë, Paneli i Apelit e gjykon të
5 tejkaluar argumentin e mëtejshëm të z. Shala se Trupi Gjykses
6 gaboi në kuadër të të njëjtit konstatim që arriti në
7 përfundimin se ky ishte i vetmi deduksion i arsyeshëm.

8 Sikurse shpjegohet në aktgjykimin e apelit, prapësimi i
9 këtij konstatimi, në vetvete, nuk ka ndikim në verdiktin e
10 fajësisë së z. Shala për krimin e luftës të ndalimit arbitrar.

11 Paneli tani do të trajtojë argumentet e z. Shala në
12 lidhje me synimin kriminal për ndalimin arbitrar.

13 Së pari, Paneli i Apelit vëren se krahas konstatimit se
14 sjellja e kryesit ishte e qëllimshme, elementi i synimit
15 kriminal mund të përmbushet duke provuar se kryesi ose: një,
16 nuk kishte arsye të besonte se shqetësimit për sigurinë e
17 palëve në konflikt e bënin ndalimin absolutisht të
18 domosdoshëm; ose dy, e dinte se të ndaluarve nuk iu ishin
19 akorduar garancitë e duhura procedurale.

20 Paraprakisht, dhe duke qenë se prapësoi konstatimin në
21 lidhje me veprimin e fajshëm që sapo u diskutua, Paneli i
22 Apelit, me nismën e vet, prapëson edhe konstatimin e Trupit
23 Gjykses për synimin kriminal përkatës se "kryesit, ndër ta
24 edhe z. Shala, nuk kishin arsye të besonin se shqetësimet për
25 sigurinë e bënin ndalimin e këtyre personave absolutisht të

1 domosdoshëm".

2 Në vijim të arsye në aktgjykimin e apelit, prapësimi i
3 këtij konstatimi nuk ka ndikim në verdiktin e fajësisë së z.
4 Shala për krimin e luftës të ndalimit arbitrar.

5 Duke iu kthyer argumenteve të z. Shala në lidhje me
6 synimin kriminal, z. Shala pretendoi se dijenia e tij nuk mund
7 të deduktohej vetëm mbi bazën e pranisë së tij në FMK. Paneli
8 i Apelit konstaton se Trupi Gjykses nuk nxori përfundimin se
9 z. Shala kishte dijeni për ndalimin e arbitrar "vetëm mbi
10 bazën e pranisë së tij në FMK". Përkundrazi, përfundimi i
11 Trupit Gjykses për dijeninë e tij u bazua në pjesëmarrjen
12 personale dhe praninë e z. Shala në kryerjen e krimit të
13 ndalimit arbitrar dhe të krimeve të tjera. Paneli i Apelit
14 rrëzon parashtrimet e tjera të z. Shala në mbështetje të këtij
15 argumenti, për arsyet e shtjelluara në aktgjykimin e apelit.

16 Si rezultat, dhe bazuar në arsyetimin e mëtejshëm në
17 aktgjykimin e apelit, Paneli i Apelit konstaton se z. Shala
18 nuk ka arritur të provojë se Trupi Gjykses gaboi në nxjerrjen
19 e përfundimit se ai përmbushi elementin e synimit kriminal në
20 lidhje me krimin luftës së ndalimit arbitrar në një konflikt
21 të armatosur jo-ndërkombëtar.

22 Paneli tani do të trajtojë kundërshtimet e z. Shala ndaj
23 konstatimeve të Trupit Gjykses në lidhje me verdiktin e
24 fajësisë së z. Shala për ndalim arbitrar në bazë të NPK 1.

25 Së pari, z. Shala argumentoi se Trupi Gjykses gaboi kur

1 deduktoi ekzistencën e qëllimit të përbashkët të NPK-së nga
2 praktika e veprimit në arrestimin e të ndaluarve në
3 institucionalizimin e mbajtjes në ndalim dhe keqtrajtimin
4 sistematik të të ndaluarve, ndërkohë që kishte edhe deduksione
5 të tjera të arsyeshme që mund të nxirreshin nga provat e
6 disponueshme.

7 Për arsye të diskutuara më tej në aktgjykimin e apelit,
8 Paneli konstaton se Trupi Gjykses nuk gaboi kur konstatoi se
9 anëtarë të NPK-së kishin qëllimin e përbashkët të ndalimit
10 arbitrar, marrjes në pyetje dhe torturimit të të ndaluarve në
11 FMK, të cilët akuzoheshin se simpatizonin ose se kishin lidhje
12 me autoritetet serbe. Paneli i Apelit gjithashtu konstaton se
13 z. Shala nuk ka arritur të provojë se Trupi Gjykses gaboi që
14 konstatoi se arrestimi i ndaluarve u krye sipas të njëjtës
15 praktikë të organizuar veprimi.

16 Rrjedhimisht, Paneli konstaton se z. Shala nuk ka arritur
17 të provojë se mbi bazën e provave që iu paraqitën Trupit
18 Gjykses asnjë gjykim i -- gjykses i arsyeshëm faktesh nuk do
19 të mund të nxirrte përfundimin se anëtarë të NPK-së kishin
20 qëllimin e përbashkët të ndalimit arbitrar të të ndaluarve në
21 FMK.

22 Sa i takon argumenteve të z. Shala në lidhje me
23 vlerësimin nga Trupi Gjykses të kontributit personal të tij në
24 NPK për ndalimin arbitrar për arsye që shpjegohen në
25 aktgjykimin e apelit, Paneli konstaton se z. Shala nuk ka

1 arritur të provojë asnjë gabim në konstatime të Trupit
2 Gjykues, dhe në përfundimin se z. Shala dha kontribut të
3 qenësishëm në krimin e ndalimit arbitrar.

4 Së fundi, Paneli do të trajtojë argumentet e z. Shalës se
5 Trupi Gjykues gaboi që konstatoi se ai kishte synimin e
6 përbashkët me anëtarët e tjerë të NKP-së për kryerjen e
7 ndalimit arbitrar duke qenë se NKP-ja nuk lejon verdikte
8 fajësie bazuar në fajësinë për shkak të anëtarësisë.

9 Paneli i Apelit gjykon se z. Shala nuk ka shpjeguar se si
10 konstatimet e Trupit Gjykues në lidhje me synimin e tij do të
11 përbënin "fajësi për shkak të anëtarësisë". Sido që të jetë,
12 lidhja midis z. Shala dhe krimit të ndalimit arbitrar nuk
13 rrjedh nga anëtarësia e tij në NPK por nga kontributi i
14 qenësishëm i tij në NPK dhe synimi i përbashkët me anëtarë të
15 tjerë të NPK-së për të kryer krimin e ndalimit arbitrar dhe
16 për të marrë pjesë në planin e përbashkët që synonte kryerjen
17 e tij. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon argumentin e z. Shala në
18 lidhje me këtë aspekt.

19 Si përfundim. Paneli i Apelit rrëzon Nënrikën 8(A), Pikën
20 11, miraton pjesërisht Pikën 12, dhe rrëzon pjesën tjetër të
21 Pikës 12 të apelit.

22 Paneli do të bëjë tani një përmbledhje të konstatimeve të
23 veta në lidhje me kundërshtimet e z. Shala në Pikën 13 të
24 apelit në lidhje me krimin e luftës së vrasjes së paligjshme.

25 Z. Shala apeloj konstatimet e Trupit Gjykues në lidhje me

1 verdiktin e fajësisë së tij për krimin e luftës të vrasjes
2 sipas Pikës 4 në lidhje me viktimën e vrasjes së paligjshme,
3 4, kryer sipas NKP I më 15 qershor 1999 ose rreth kësaj date
4 në FMK.

5 Për t'i trajtuar plotësisht argumentet e z. Shala, Paneli
6 i Apelit fillimisht vlerësoi parashtrimet e tij se Trupi
7 Gjykues gaboi kur deduktoi se vrasja e paligjshme ishte pjesë
8 e qëllimit të përbashkët të NPK-së. Pas kësaj, Trupi Gjykues
9 vlerësoi parashtrimin e z. Shala se Trupi Gjykues gaboi kur
10 konstatoi se ai kishte synimin e nevojshëm për kryerjen e
11 vrasjes së paligjshme.

12 Fillimisht Paneli vëren se kuadri i synimit të përbashkët
13 të NPK-së në këtë çështje gjyqësore është i ngushtë dhe në
14 veçanti karakterizohet nga një periudhë e kufizuar kohe prej
15 më pak se tri javësh nga ndalimi fillestar i të ndaluarve në
16 FMK rreth datës 17 maj 1999 deri në vdekjen e viktimës së
17 vrasjes së paligjshme në 5 qershor 1999 ose rreth kësaj date.
18 Paneli vëren gjithashtu se konstatimi i Trupit Gjykuese se në
19 këtë rast qëllimi i përbashkët përfshinte vrasjen e paligjshme
20 nuk përbën konstatim se FMK-ja ishte një kamp ndalimi i
21 krijuar posaçërisht me qëllimin për të vrarë persona të
22 ndaluar.

23 Paneli do të trajtojë tani kundërshtimet konkrete të z.
24 Shala lidhur me qëllimin e përbashkët të NKP-së.

25 Së pari, z. Shala argumentoi se Trupi Gjykues gaboi që

1 deduktoi se vrasja e paligjshme ishte pjesë e qëllimit të
2 përbashkët të NPK-së bazuar në mënyrën se si u keqtrajtuan
3 disa të ndaluar. Paneli vlerëson se deduksioni alternativ i
4 propozuar nga z. Shala se qëllimi i kryesve ishte vetëm që të
5 keqtrajtonin jo t'i vrisnin të ndaluarit nuk mbështetet në
6 provat e administruara. Ndër këto prova është keqtrajtimi i
7 rendit të ndaluarve, përfshirë gjatë incidentit të 20 majit
8 1999 kur kryesit vazhduan t'i rrihnin të ndaluarit me mjete të
9 ndryshme, përfshirë me një armë që u përdor si mjet i fortë
10 edhe pasi ata kishin humbur vetëdijen. Z. Shala argumentoi
11 gjithashtu se kryesit nuk kishin synimin për të vrarë para ose
12 pas incidentit të qëllimit me armë zjarri në këmbë më 4
13 qershor 1999 ose rreth kësaj date, sepse viktima e vrasjes së
14 paligjshme u qëllua me armë zjarri në këmbë dhe u kthye në
15 dhomë i gjallë. Paneli gjykon këto argumenti jobindës bazuar
16 në konstatimet e Trupit Gjykses se: një, anëtarët e NPK-së
17 vazhduan të keqtrajtonin viktimën e vrasjes së paligjshme pasi
18 e qëlluan me armë zjarri; dhe së dyti, kjo shkaktoi
19 gjakderdhje të madhe që kërkonte ndihmë mjekësore; dhe tre, në
20 vend që të kërkonin trajtim mjekësor, kryesit vazhduan ta
21 rrihnin viktimën e vrasjes së paligjshme.

22 Së dyti, z. Shala argumentoi se Trupi Gjykses gaboi kur
23 konstatoi se qëllimi i përbashkët i NPK-së përfshinte vrasjen
24 e paligjshme, duke u mbështetur në deklaratat e bëra nga
25 anëtarë të NPK-së, përfshirë nga z. Shala, për të provuar

1 synimin për të vrarë të ndaluarit.

2 Në lidhje me këtë, Paneli i Apelit vlerëson fillimisht se
3 për të vërtetuar se qëllimi i përbashkët i NPK-së përfshinte
4 vrasjen e paligjshme nuk ishte e nevojshme që Trupi Gjykses të
5 vërtetonte se z. Shala kishte synimin të vriste një person
6 konkret, përkatësisht viktimën e vrasjes së paligjshme, por se
7 ai kishte të njëjtin synim me anëtarë të tjerë të NPK-së.

8 Gjithashtu, Paneli vlerëson si bindëse provat ku u
9 mbështet Trupi Gjykses për të konstatuar se anëtarë të NPK-së
10 kishin synimin për të vrarë. Këto prova përfshijnë: një,
11 deklarata të ndryshme të cilat diskutohen më tej në
12 aktgjykimin e apelit; dy, fakti që z. Shala mori pjesë në
13 keqtrajtimin e viktimës së vrasjes së paligjshme gjatë
14 incidentit të qëllimit me armë zjarri në këmbë me 4 qershor
15 1999 ose rreth kësaj date; dhe tre, se z. Shala ishte i
16 pranishëm kur anëtarët e tjerë të NPK-së qëlluan me armë
17 zjarri viktimën e vrasjes së paligjshme dhe pa pasojat e
18 shkaktuara nga kjo.

19 Rrjedhimisht, Paneli gjykon se Trupi Gjykses nuk gaboi
20 kur arriti në përfundimin se qëllimi i përbashkët i NPK-së
21 përfshinte vrasjen e paligjshme përmes konstatimit se anëtarët
22 e NPK-së, ndër të cilët z. Shala, kishin synimin për të vrarë
23 të ndaluarit.

24 Së fundi, Paneli trajton kundërshtimin e tretë të z.
25 Shala në lidhje me deduksionin e Trupit Gjykses se vrasja e

1 paligjshme ishte pjesë e qëllimit të përbashkët të NPK-së;
2 konkretisht, konstatimin e tij se synimi për të vrarë u
3 manifestua edhe nga refuzimi i qëllimshëm i trajtimit mjekësor
4 për viktimën e vrasës së paligjshme.

5 Sa i takon argumentit të z. Shala se provat sugjerojnë që
6 anëtarëve të UÇK-së u erdhi keq për vdekjen e viktimës së
7 vrasjes së paligjshme dhe morën masa të menjëhershme për
8 përmirësimin e kushteve në FMK, Paneli vëren se z. Shala e
9 ngriti këtë argument gjatë gjykimit dhe ai u hodh poshtë nga
10 Trupi Gjykses që përlligj rrëzimin e tij të menjëhershëm në
11 apel.

12 Sido që të jetë, Paneli rikujton provat e shqyrtuara nga
13 Trupi Gjykses që pas incidentit të qëllimit me armë zjarri në
14 këmbë më 4 qershor 1999 ose rreth kësaj date, ishte e qartë se
15 viktimat e vrasjes së paligjshme kishte nevojë për ndihmë, por,
16 megjithatë, në vend që të kërkonin trajtimin mjekësor kryesit
17 vazhduan ta rrihnin viktimën e vrasjes së paligjshme i cili më
18 vonë vdiq në ndalim në FMK. Bazuar në prova të mëtejshme të
19 diskutuara në aktgjykimin e apelit si dhe në konstatimet e
20 Trupit Gjykses në tërësi, Paneli gjykon se z. Shala nuk ka
21 arritur të provojë se Trupi Gjykses gaboi që nuk mori parasysht
22 se ndryshimi i kushteve pas vdekjes së viktimës së vrasjes së
23 paligjshme tregoi keqardhjen e anëtarëve të NPK-së.

24 Sa i takon argumentit të z. Shala se ai nuk kishte asnjë
25 lidhje me urdhrin për refuzimin e trajtimit mjekësor, Paneli i

1 Apelit rikujton se nga pikëpamje ligjore nuk është nevojshme
2 që z. Shala të ketë qenë personalisht i përfshirë në të gjitha
3 faktet mbi të cilat u mbështet Trupi Gjykses për të deduktuar
4 ekzistencën dhe llojin e qëllimit të përbashkët. Paneli vëren
5 gjithashtu se Trupi Gjykses nuk e mbështeti përfundimin se z.
6 Shala kontribuoi në NPK në ndonjë konstatim lidhur me
7 dijeninë, përfshirjen ose përgjegjësinë e tij për refuzimin e
8 trajtimit mjekësor për viktimën e vrasjes së paligjshme.

9 Rrjedhimisht, Paneli e rrëzon argumentin e z. Shala në
10 lidhje me këtë pikë.

11 Në përfundim, Paneli ka marrë parasysh deduksionet e
12 Trupit Gjykses të marra së bashku në konstatimin e vet se
13 vrasja e paligjshme ishte pjesë e qëllimit të përbashkët të
14 NKP-së dhe konstaton se z. Shala nuk ka provuar se asnjë
15 gjykses i arsyeshëm faktesh nuk mund të arrinte në përfundimin
16 e Trupit Gjykses si i vetmi deduksion i arsyeshëm.

17 Rrjedhimisht Paneli e rrëzon pjesërisht Pikën 13 të apelit.

18 Paneli i Apelit do të trajtojë tani parashtrimet e tjera
19 të z. Shala në Pikën 13 të apelit se Trupi Gjykses gaboi që
20 konstatoi sa ai kishte synimin e nevojshëm për të kryer krimin
21 e vrasjes së paligjshme.

22 Paneli do të fillojë me parashtrimin e z. Shala se nuk
23 është paraqitur asnjë provë në bazë të së cilës Trupi Gjykses
24 do të deduktonte logjikisht dëshirën e tij për të vrarë
25 viktimën e varjes së paligjshme. Paneli i Apelit nuk pajtohet

1 me këto parashtime dhe miraton mbështetjen e Trupit Gjykues
2 në deklaratën e Dëshmitarit 4733 ku dëshmitari pohoi se z.
3 Shala i tha atij, "Kemi me të vra, kemi me të ekzekutu".
4 Paneli miraton gjithashtu mbështetjen e Trupit Gjykues në
5 provat e tjera rrethanore në këtë çështje që mbështesin
6 konstatimin se z. Shala kishte synimin për të kryer krimin e
7 vrasjes së paligjshme. Në lidhje me këtë, Paneli iu referohet
8 konstatime të Trupit Gjykues për pjesëmarrjen personale dhe
9 aktive të z. Shala në keqtrajtimin e rëndë dhe brutal të të
10 ndaluarve gjatë incidentit të 20 majit 1999. Gjithashtu,
11 Paneli iu referohet konstatimeve të Trupit Gjykuese më 4
12 qershor 1999 ose rreth kësaj date, z. Shala mori pjesë në
13 keqtrajtimin e viktimës së vrasjes së paligjshme, se ai ishte
14 i pranishëm kur anëtarë të tjerë të NPK-së qëlluan me armë
15 zjarri viktimën e vrasjes së paligjshme dhe se ai vazhdoi të
16 merrte pjesë në keqtrajtimin e viktimës së vrasjes së
17 paligjshme pas qëllimit të tij me armë zjarri.

18 Në lidhje me argumentin e z. Shala se, edhe nëse merret
19 me shkallën më të lartë të besueshmërisë, deklarata e
20 Dëshmitarit 4733 tregon vetëm synimin e tij për të vrarë
21 Dëshmitarin 4733, jo viktimën e vrasjes së paligjshme, Paneli
22 rikujton se për krimet të kryera në kuadër të NPK-së, nuk
23 është e domosdoshme të vërtetohet pjesëmarrja e të akuzuarit
24 në kryerjen e një krimi konkret. Në këtë çështje, Trupi
25 Gjykues kishte për detyrë të vërtetonte përgjegjësinë e të

1 akuzuarit në realizimin e qëllimit kriminal të përbashkët që
2 përfshinte vrasjen e paligjshme të të ndaluarve në FMK. Paneli
3 është bindur se Trupi Gjykses nuk gaboi që u mbështet në
4 deklaratën e Dëshmitarit 4733 për të arritur në konstatimet e
5 veta.

6 Sa i takon formës së synimit të z. Shala, ndonëse
7 konstatimet e Trupit Gjykses mund të kishin qenë më të qarta
8 në disa aspekte, Paneli vëren se Trupi Gjykses, megjithatë,
9 theksoi se z. Shala kishte synimin e drejtpërdrejtë për të
10 vrarë.

11 Paneli shqyrtoi gjithashtu parashtrimet e z. Shala se ai
12 nuk e kreu vetë krimin e vrasjes së paligjshme. Megjithatë,
13 Paneli rikujton se z. Shala nuk u shpall fajtor për kryerjen e
14 veprimit të fajshëm të krimit të vrasjes së paligjshme nga
15 vetë ai dhe se ligji mbi NPK-në nuk vendos kushtin që i
16 akuzuari të ketë kryer veprimin e fajshëm të krijimit ose të
17 një pjesë të tij. Sipas Panelit, rëndësia dhe shkalla
18 pjesëmarrjes së z. Shala në NPK u vlerësuan siç duhet nga
19 Trupi Gjykses.

20 Rrjedhimisht, argumenti i z. Shala se ai nuk kishte
21 përfshirë drejtpërdrejt në kryerjen e krimit të vrasjes së
22 paligjshme nuk cenon konstatimet e Trupit Gjykses për
23 rëndësinë e kontributit të tij në planin e përbashkët.

24 Paneli i Apelit gjykon se z. Shala nuk ka arritur të
25 provojë se Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se ai ishte pjesë

synimit të përbashkët për të kryer krimin e vrasjes së paligjshme. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon Pikën 13.

Tani paneli do të trajtojë pretendimet e z. Shala për gabime në lidhje me dhënien e dënimit të ngritura në Pikën 14 të apelit.

GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Së fundi, në Pikën 14 të apelit, z. Shala kundërshton konstatimet e Trupit Gjykues në lidhje me dënimin me 18 vjet burg për tri akuzat për të cilat ai u shpall fajtor.

Së pari, në lidhje me shkallëzimin e zbatueshëm të dënimit, Paneli i apelit gjykon se Trupi Gjykues nuk gaboi që vlerësoi se duhej të merrte parasysh shkallëzimin e dënimeve sipas legjislacionit vendor por ato nuk ishin detyruese për të. Paneli i Apelit gjykon gjithashtu se duke pasur parasysh aktgjykimin e Dhomës së Gjykatës Kushtetuese në çështjen gjyqësore Mustafa, shkallëzimi më i butë i dënimit sipas legjislacionit vendor që duhet të merret parasysh është 5 deri në 15 vjet burgim në pajtim me Kodin Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, të vitit 1976, ndryshuar në Rregulloren 1990/24 të UNMIK-ut. Sido që të jetë, ky shkallëzim i dënimeve sipas legjislacionit vendor nuk kufizon kompetencën diskrecionale të Dhomave të Specializuara për të dhënë dënimin më të lartë deri në burgim të përjetshëm në përputhje me nenin 44(1) të Ligjit. Gjithashtu, për arsyet që shtjellohen më tej në aktgjykimin e apelit, Paneli nuk

1 gjykon se është bërë shkelje e parimit të ligjshmërisë sa u
2 takon dispozitave ligjore në lidhje me dënimet.

3 Së dyti, në lidhje me faktorët që morën parasysh në
4 dhënien e dënimit, Paneli i Apelit gjykon se z. Shala nuk
5 arriti të identifikonte gabime në lidhje me konstatimet e
6 Trupit Gjykues dhe rrëzon kundërshtimet që lidhen me.

7 Sa i takon argumentit të z. Shala se ai nuk kishte rol
8 udhëheqës në FMK, Paneli i Apelit konstaton se Trupi Gjykues
9 gaboi kur nuk i dha peshë të mjaftueshme faktit se z. Shala
10 nuk kishte rol komandues sa i përket kontributit personal të
11 tij në krimin e vrasjes së paligjshme. Paneli i Apelit trajton
12 më poshtë ndikimin e këtij gabimi në dënimin që iu dha z.
13 Shala.

14 Paneli rrëzon pretendimet e z. Shala në lidhje me të
15 gjithë faktorët e tjerë lehtësues.

16 Së fundi, Paneli i Apelit trajton argumentin e z. Shala
17 lidhur me pretendimet se Trupi Gjykues nuk garantoj barazinë
18 dhe keqpërdori diskrecionin kur dha një dënim paarsyeshmërisht
19 joproporcional krahasuar me çështjet gjyqësore të ngjashme.

20 Paneli i Apelit fillimisht rrëzon argumentin e z. Shala
21 se Trupi Gjykues nuk dha mendim të arsyetuar pse vendosi të
22 vijonte kaq konsiderueshëm prej atyre dënimeve.

23 Sa i takon themelësisë së ankesës, Paneli rikujton se
24 është plotësisht i vetëdijshëm për diskrecionin e gjerë të
25 Trupit Gjykues në dhënien e dënimit. Megjithatë duke marrë

1 parasysh të gjithë faktorët relevantë dhe rrethanat
2 individuale në këtë çështje, Paneli gjykon se ka mospërputhje
3 ndërmjet dënimeve që iu dhanë z. Shala dhe dënimeve të tjera
4 të analizuara prej tij. Paneli gjykon, në veçanti, se dënimi i
5 formës së prerë me 15 vjet burgim për z. Mustafa, i cili
6 kishte pozitë komanduese, tregon se në këtë rast Trupi Gjykses
7 i tejkaloi kufijtë e diskrecionit të vet duke i dhënë z. Shala
8 dënime jashtë proporcionit të arsyeshëm krahasuar me çështje
9 të ngjashme.

10 Rrjedhimisht, Paneli miraton pjesërisht kundërshtimet e
11 z. Shala ndaj konstatimeve të Trupit Gjykses për masën e
12 dënimit dhe rrëzon pjesën tjetër të argumenteve të tij në
13 kuadër të Pikës 14 të apelit.

14 Lidhur me ndikimin e konstatimeve të Panelit të Apelit
15 për gabime në dënimet që iu dhanë z. Shala, Paneli rikujton së
16 pari se ai prapësoi konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me
17 dy viktima të ndalimit arbitrar dhe pesë viktima të torturës.
18 Së dyti, Paneli konstatoi se Trupi Gjykses nuk i dha peshë të
19 mjaftueshme faktit se z. Shala nuk kishte rol komandues në
20 lidhje me krimin e vrasjes së paligjshme. Së treti, Trupi
21 Gjykses keqpërdori diskrecionin e tij duke i dhënë z. Shala
22 dënime joproporcionale.

23 Rrjedhimisht, Paneli i Apelit e gjykon të arsyeshme që të
24 ulë pjesërisht dënimet individuale që iu dhanë z. Shala nga
25 Trupi Gjykses. Megjithatë, Paneli i Apelit thekson se ulja e

1 dënimeve të z. Shala nuk sugjeron aspak se krimet për të cilat
2 ai është shpallur fajtor dhe dënuar nuk janë të rënda.

3 Paneli i Apelit thekson gjithashtu se ka lënë në fuqi
4 verdiktin e fajësisë së z. Shala për krimin e luftës të
5 ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes sipas Pikave 1, 3 dhe
6 4 të aktakuzës, përkatësisht, për të cilat u konstatua se mban
7 përgjegjësi penale individuale.

8 Së fundi, Paneli i Apelit rikujton se Dhomat e
9 Specializuara kanë juridiksion vetëm mbi persona, jo grupe apo
10 organizata. Në përputhje në këtë, Paneli i Apelit thekson se
11 as UÇK-ja as populli i Kosovës nuk ishin objekt i këtij
12 procesi dhe ata nuk janë gjykuar përgjegjës apo shpallur
13 fajtorë për këto krime.

14 Tani do t'i kërkoj z. Shala të ngrihet në këmbë ndërkohë
15 që, në emër të Panelit do të lexoj tekstin e plotë të pjesës
16 vendimore të aktgjykimit të apelit.

17 Z. Shala, a mund të ngriheni.

18 GJYKATËSJA PICARD: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Mund
19 të ngriheni z. Shala, në këmbë?

20 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Ndoshta Avokati i Mbrojtjes
21 së z. Shala mund ta bindë z. Shala që të ngrihet në këmbë?

22 Z. GILISSEN: [Përkthim] A mund të më jepni pak kohë?

23 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Mund të bëjmë një pushim dy,
24 tre minuta. Por përndryshe në qoftë se nuk ngrihet në këmbë ne
25 do të vazhdojmë me leximin e aktgjykimit.

1 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

2 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Bëjmë një pushim të
3 ndërprerjes së seancës pesë minuta.

4 --- Seanca ndërpritet në orën 12.50

5 --- Seanca rifillon në orën 13.03

6 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Rifillojmë seancën. Do t'i
7 kërkoj përsëri edhe një herë z. Shala që të ngrihet në këmbë
8 ndërkohë që lexoj vendimin e plotë të aktgjykimit të apelit.

9 Faleminderit shumë, z. Shala.

10 Vendimi është si në vijim:

11 Për arsyet e lartpërmendura pasi ka shqyrtuar të gjitha
12 argumentet e paraqitura nga palët dhe pjesëmarrësit, Paneli i
13 Gjykatës së Apelit në bazë të nenit 46 të Ligjit dhe
14 rregullave 182 dhe 183 të Rregullores:

15 Miraton pjesërisht Pikën 7, pjesërisht Pikën 12 dhe
16 pjesërisht Pikën 4 të apelit të z. Shala. Prapëson pjesërisht
17 verdiktet e fajësisë për Pikat 1 dhe 3 të aktakuzës në lidhje
18 me pjesët e tyre që bazohen në ndalimin arbitrar të dy
19 personave dhe torturimin e pesë personave;

20 Rrëzon apelin e z. Shala për të gjitha aspektet e tjera;

21 Lë në fuqi pjesën tjetër të verdiktit të fajësisë së z.
22 Shala për krimin e luftës së ndalimit arbitrar në bazë të
23 nenit 14(1)(c) dhe nenit 16(1)(a) të Ligjit sipas Pikës 1 të
24 aktakuzës, krimin e luftës të torturës në bazë të nenit
25 14(1)(c)(i) dhe nenit 16(1)(a) të Ligjit sipas Pikës 3 të

1 aktakuzës dhe krimin e luftës së vrasjes së paligjshme në bazë
2 të nenit 14(1)(c)(i) dhe nenit 16(1)(a) të Ligjit sipas Pikës
3 4 të aktakuzës;

4 Lë në fuqi dënimin me gjashtë vjet burgim për Pikën 1 të
5 aktakuzës;

6 Anulon dënimin me 16 vjet burgim në lidhje me Pikën 3 të
7 aktakuzës dhe cakton një dënim me 13 vjet burgim;

8 Anulon dënimin me 18 vjet burgim në lidhje me Pikën 4 të
9 aktakuzës dhe cakton një dënim me 13 vjet burgim;

10 Anulon dënimin e njehsuar me 18 vjet burgim për z. Shala,
11 dhe cakton një dënim të njehsuar me 13 vjet burgim për z.
12 Shala duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim;

13 Vendos që ky aktgjykim të zbatohet me efekt të
14 menjëhershëm në bazë të rregullës 185(1) të Rregullores;

15 Urdhëron që në pajtim me nenin 50(1) të Ligjit dhe
16 rregullën 166(3) të Rregullores z. Shala të mbetet në
17 paraburgim të Dhomave të Specializuara deri në finalizimin e
18 masave për transferimin e tij në shtetin ku do të vuajë
19 dënimin; dhe

20 Do të shqyrtojë apelin e z. Shala kundër urdhrit për
21 zhdëmtim.

22 Z. Shala, mund të uleni.

23 GJYKATËSJA PICARD: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Nuk e
24 di a më dëgjoni, po unë nuk ju dëgjoj dot. Nuk më vjen zëri.

25 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Gjykatëse, znj.

1 Gjykatëse, a mund të më dëgjoni?

2 GJYKATËSJA PICARD: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po,
3 ju dëgjoj. Po ju a më dëgjoni?

4 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Po.

5 GJYKATËSJA PICARD: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]
6 Faleminderit. Tani Zyra Administrative do ta shpërndajë
7 aktgjykimin e apelit në formë elektronike.

8 Z. Sekretar i Gjykatës, a mund të konfirmoni që është
9 shpërndarë?

10 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
11 aktgjykimi i apelit në versionin konfidencial dhe versionin e
12 redaktuar publik u janë shpërndarë në mënyrë elektronikë
13 palëve relevante.

14 GJYKATËSJA PICARD: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Këtu
15 përfundon procesi i apelit në lidhje me apelin e z. Shala kundër
16 aktgjyqimit në këtë çështje gjyqësore. Përpara se të mbyllim
17 seancën shfrytëzoj rastin të falënderoj palët, pjesëmarrësit
18 dhe Zyrën Administrative për punën dhe pjesëmarrjen e tyre
19 sot. Gjithashtu u shpreh mirënjohjen përkthyesve,
20 stenografistëve, personelit për teknikën audiovizuale,
21 personelit të sigurisë dhe ekipin ligjor mbështetës të Panelit
22 të Apelit për punën e tyre të shkëlqyer dhe ndihmën e tyre.

23 Seanca mbyllet

24 --- Seanca mbyllet në orën 13.09

25